



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr 42 date 27/04/2001

MBI

**KALIMIN E NDERMARRJES SE SHERBIMEVE TE KOMUNALE
BANESAVE NE SHOQERI SHTETRORE, SH.A.**

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, Ligjit Nr.8654 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Tiranë” Ligjit Nr.7776 DT.22.12.1993 “Për buxhetin lokal në Republikën e Shqipërisë, Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.21 dt.13.02.2001 “Për miratimin e Ndërmarrjes Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit” me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Ndërmarrja e “Shërbimeve Komunal Banesave” deri tani financuar 70% nga buxheti, të shndërrohet në Shoqëri Shtetore, SH.A. në të cilën të gjitha aksionet të zotërohen nga shteti.
2. Pranë Ndërmarrjes Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit të ekzistojë një sektor buxhetor prej 20 vetash të cilët do të merren me mirëmbajtjen e vendstrehimeve dhe bodrumeve në qytetin e Tiranës dhe detyra të tjera. Pika 1 e vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.21 dt.13.02.2001 “Për miratimin e Ndërmarrjes Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit” ku kjo ndërmarrje shkrihej në sektorë shfuqizohet.
3. Emërtimi i ri i Shoqërisë SH.A. është “Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Sh.a.” Në bashkëpunim me Ndërmarrjen e Tregjeve dhe

Taksave kjo shoqëri ngarkohet me arkëtimin e të ardhurave nga tatimi mbi ndërtesat e banimit duke krijuar një sektor për këtë qëllim sipas strukturës bashkëngjitur, fondet e pagavetë të cilit do të përballohen nga të ardhurat e planifikuara për Aparatin e Bashkisë Tiranë (art.602) për muajt Prill, Maj, Qershor.Kapitali i kësaj Shoqërie do të përcaktohet sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi.

4. Proceduret e kalimit të Ndërmarrjes së Sherbimeve Komunale Banesave në “Nd. Shërbime Komunale Sh.a.” do të filloj brenda muajit Maj të vitit 2001
5. Për zbatimin e këtij vendimi dhe kryerjen e procedurave përkatëse ngarkohen, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

